

Teuta/ Ne Durres priten tre braziliane

nga AlbaniaSoccer

E enjte, 26 Dhjetor 2013 20:41



Me ardhjen e Sorrentinos ne krye te skuadres, Teuta po pergatitet per te bere disa perforcime. Klubi ka punesuar disa menaxhere te huaj qe pritet te sjellin disa futbolliste nga Brazili. Tre jane aktualisht ne Durres dhe bashke me ta priten edhe te tjere. Teuta synon te afroje elemente cilesore per pjesen e dyte te sezonit per te synuar te afrohet serish ne zonen qe do ti dergonte Djemte e Detit ne Europe edhe kete sezon. Te pakten tre futbolliste braziliane do te jene ne Durres ne janar dhe Teuta pritet ti federroje per fazen e dyte te sezonit.